



VËLLEZËR TË GJITHË:

Letra enciklike e Atit të Shenjtë Françesku mbi vëllazërinë dhe miqësinë shoqërore

MBI VARRIN E SHËN FRANÇESKUT PAPA FIRMOS ENCIKLIKËN

Në kriptën e Bazilikës inferiore të Asizit, papa Françesku, mbi varrin e Varfanjakut të Asizit, firmos Enciklikën e tij të tretë, “Vëllezër të gjithë”, të kushtuar vëllazërisë dhe miqësisë shoqërore. Një Enciklikë që e merr emrin prej fjalëve të shkruara nga shën Françesku.

MESAZHI I MINISTRI GJENERAL

Të dashur vëllezër, Zoti ju dhashtë paqe!

Me gëzim të madh vij te secili prej jush që t’ju uroj prej thellësisë së zemrës Gëzuar festën e Shën Françesku 2020. Edhe pse jemi duke jetuar një emergjencë shëndetësore botërore, asgjë nuk do të mund të na ndajë prej dashurisë së Krishtit (Rom 8,35) dhe asgjë nuk do të mund të na e heqë shpresën e gëzimit që Ungjilli dhe personi i Krishtit sjellin me vete.

Ne fretërit minorë jemi veçanërisht të lumtur për dhuratën shumë të bukur që papa Françesku sapo i ka bërë Kishës dhe të gjithë burrave e grave vullnetmirë, që do të duan ta mirëpresin mesazhin e enciklikës së tij të re “Vëllezër të gjithë”, mbi vëllazërinë dhe miqësinë shoqërore, edhe një herë i frymëzuar prej fjalëve të Varfanjakut të Asizit, në vazhdimësi të përsosur me mesazhin qendror të Laudato Si’, në të cilën na ka mësuar rëndësinë e të ndierit të ndërlidhur dhe në bashkim me gjithë botën e krijuar, duke marrë një vizion ekologjie të tërësishme. Kjo letër enciklike, siç kuptohet prej titullit, do të jetë një mesazh profetik dhe një thirrje urgjente për të kujtuar se “Hyji i ka krijuar të gjitha qeniet njerëzore të barabarta në

të drejta, detyra e dinjitet dhe i ka thirrur të jetojnë si vëllezër e motra mes tyre” (VGJ 5).

Le ta pranojmë me hapje dhe vendosmëri të madhe këtë ftesë të fuqishme që të duam të bëjmë pjesë në Ëndërrën e Hyjit. Siç thotë vetë Papa, të ëndërrojmë një njerëzim të vetëm, si udhëtarë në të njëjtin trup njerëzor, si bij të së njëjtës tokë... secili me pasurinë e fesë së tij... secili me zërin e vet, të gjithë vëllezër e motra (VGJ 8).

KËRKESË PREJ SEKRETARIT GJENERAL PËR MISIONET DHE UNGJILLËZIMIN

Shumë të dashur vëllezër,

papa Françesku na jep një tekst mbi vëllazërinë që nuk mund të na lërë mospërfillës. Le ta pranojmë atë si një ftesë që na e ka bërë, ne të cilët vëllazërinë e kemi bërë arsye jete dhe që e përshkojmë si rrugë të parë të ungjillëzimit.

Si “Vëllazëri minorësh soditës në misionin ungjillëzues”, le ta bëjmë tonën këtë ftesë për të jetuar dhe për të ndërtuar (duke qenë shenja e mjete) Vëllazërinë dhe Miqësinë Shoqërore, si dhe le të përpiqemi ta bëjmë të njohur dhe ta vëmë në jetë.

Na bëni të ditur se çfarë keni ndër mend të bëni – ose jeni tashmë duke bërë – për:

1. Ta bërë të njohur përmbajtjen e Enciklikës.
2. Nisma për ta vënë atë në jetë.

Në këtë mënyrë mund të bashkëndajmë atë që bëhet në të gjitha entitetet tona, në mënyrë që së bashku të mund të jemi të nxitur dhe të mësojmë prej njëri-tjetrit. (Email: evangen@ofm.org)

LAJME TË TJERA



E nderueshmja Françeska e të Zënit të Papërlyer Pascual Doménec, Themeluese e Kongregatës së Motrave Françeskane të Zojës së Papërlyer

Më 29 shtator 2020, Ati i Shenjtë Françesku ka autorizuar Kongregatën e Çështjeve të Shenjtërve për të shpallur Dekretin në lidhje me virtutet heroike të Shërbëtores së Hyjit Françeska e të Zënit të Papërlyer Pascual Doménec, Themeluese e Kongregatës së Motrave Françeskane të Zojës së Papërlyer; e lindur më 13 tetor 1833 në Monkada (Spanjë) dhe e vdekur po aty më 26 prill 1903.

E nderueshmja Françeska Pascual Doménec (1833-1903) i kaloi vitet e para të jetës rregulltare në kuvendin e Terciareve të shën Françeskut të qytetit të Valencias. Pasi u zgjodh epre e bashkësisë u propozoi shoqeve të veta zbatimin e kushtetutave të reja të përqendruara në dashurinë për varfërinë, për dëgjuesin dhe për ushtrimin e veprave të bamirësisë. Arqipeshkvi i Valencias e miratoi reformën në vitin 1876. Kështu do të lindte Kongregata e Motrave Françeskane të Zojës së Papërlyer, të kushtuara apostullatit të sugjeruar prej nevojave të kohës, veçanërisht edukimi njerëzor dhe i krishterë i fëmijëve e i të rinjve, sidomos të verbër e shurdhmemecë, dhe qendrat e mbrojtjes për të rejtat.

Çështja e lumnimit filloi në vitin 1989.



COMPI: Këshilli i ri i Presidencës

Konferenca e Ministrave provincialë të fretërve minorë të Italisë dhe Shqipërisë (COMPI) ka zgjedhur Këshillin e ri të Presidencës për trevjeçarin 2020/2023.

Janë zgjedhur: fra Massimo Fusarelli (Lacio-Abruco): President; fra Paolo Quaranta (Leçe): zëvendës President; fra Francesco Piloni (Umbria-Sardenja): Këshilltar; fra Livio Crisci (Toskana): Këshilltar.

Një blog i ri françeskan ndërkombëtar

Franciscan Connections është një blog françeskan ndërkombëtar që lidh, komunikon dhe transmeton studimet më të mira françeskane të shekullit të 21-të. Objektivi është ai që ta vërë njohjen e studimeve françeskane bashkëkohore dhe të aplikuar në dispozicion të një bote më të gjerë studiuesish, profesionistësh, bashkësish të ndryshme dhe të një brezi të ri destinatarësh të vetëdijshëm për ndihmesën që një njohje e fortë e studimeve françeskane mund t'u japë vëmendjetemave aktuale politike, shoqërore, etike dhe kishtarë.

Franciscan Connections është një partnership mes Qendrës së Studimeve Françeskane të Universitetit të Tilburgut, Hollandë, dhe Institutit françeskan të Universitetit të Shën Bonaventurës, Nju Jork, SHBA.

Siti web:

www.franciscanconnections.com

Irlandë: Një vëllazëri e vërtetë ndërkombëtare

Këtë vit Noviciati Ndërkombëtar OFM i Kilërneit, Irlandë, ka pranuar tre novicë: Koen Van Durme, belg, por novic i Provincës hollandeze; Matthias Borchardt, i Provincës gjermane; Niklaus Meienberg, i Kustodies



zvicëranë, në varësi të Provincës austro-italiane të Shën Leopoldit. Mësuesi i novicëve, Antony Jukes, është anglez dhe trupa mësimeve përfshin një frater danez, një frater gjerman dhe fraterit irlandezë. Kilërnei është një vend popullor turistik dhe vendasit që frekuentojnë kuvendin janë të mësuar me vizitorët ndërkombëtarë e me një larmi të madhe theksesh.

Sloveni: Etapat më të rëndësishme të jetës së shën Françeskut në një relikuar

Gjatë festës së Shën Françeskut të Asizit, 4 tetor 2020, është bekuar një relikuar i ri në nder të shën Françeskut në Shenjtëroren Mariane Kombëtare në Brezje, Sloveni. Relikiari i ri vë në dukje përvjetorët e shumtë të jetës së Shën Françeskut që kremtojmë. Përvjetorë që përfaqësojnë 800 vjet histori të jetës së shenjtë.

Vepra e jashtëzakonshme e artit e z. Christoph Steidl Porenta, paraqet shtatë skena të jetës së Françeskut: Françesku heq dorë prej jetës së tij kalorësiake; Françesku i kthen rrobat e tij të atit; Françesku përqafton Krishtin; Françesku u predikon njerëzve; themelimi i Urdhrit të Fretërve Minorë; Françesku dhe Sulltani; Françesku merr varrët.

Për fotografitë në cilësi të lartë:

www.marija.si



BOTIME TË REJA FRANÇESKANE



Suzanne Giuseppi Testut

EL COMBATE ESPIRITUAL
A la luz de san Francisco de Asís y de sus hermanos

efaranizazu


SUZANNE GIUSEPPI TESTUT
OFS, *El combate espiritual. A la luz de san Francisco de Asís y de sus hermanos (Lufta shpirtërore. Në dritën e shën Françeskut të Asizit dhe të vëllezërve të tij)*, Ediciones Franciscanas Arantzazu, Oñati 2020, fq. 188

Nuk ka jetë pa luftë, pa betejë. Ky është dimension i thelbësor për rritjen tonë njerëzore dhe shpirtërore. Si nxënëse entuziaste dhe besnike e Françeskut të Asizit, Suzanne na fton të meditojmë mbi këtë luftë në dritën e vetë Françeskut që, nëpërmjet dëshirave, betejave, dështimeve e fitoreve të tij, na zbulon një mesazh të fuqishëm shprese, na pëshpërit këshilla të çmueshme të vlefshme e aktuale, na shkund fort në siguri dhe zakonet tona. Një meditim që na fton t'i kapërcejmë verbëritë dhe ambiciet tona, ato që na pengojnë të duam dhe të lejojmë të duhemi.



FABIO SCARSATO OFMConv, *Prima e dopo. I protomartiri francescani, Antonio di Padova e Francesco d'Assisi (Më parë e më pas. Protomartirët françeskanë, Antoni i Padovës dhe Françesku i Asizit)*, Edizioni Messaggero Padova, Padova 2020, fq. 132


Me prejardhje nga Umbria Jugore, protomartirët françeskanë e ndoqën Françeskun deri në Porciunkola nga ku u dërguan për të predikuar në tokën e jo të krishterëve. Entuziazmi i tyre duhej të ishte i madh por në përpjesëtim të zhdrejtë me përgatitjen, siç ndodhte, ndër të tjera, edhe për fretërit e tjerë të dërguar në terriore të ndryshme. Kjo jetë e re e shprehur në dhurimin e plotë e mahniti kanonikun agustinian Fernando da Lisbona që në Koimbra, duke parë pesë fretërit minorë të parë të martirizuar, vendosi të bëhej françeskan duke marrë emrin Anton. Pikërisht martirët janë dëshmitarë me jetë edhe të asaj ekonomie ungjillore të frat Françeskut që ka ditur të mahnisë dhe të motivojë gjatë shekujve zgjedhje ekonomike alternative me ato të një tregu të përfitimit të pastër.



JOHN AROKIAM OFM, *Sparkling the Joy of Truth. Global Compact on Education (Ngjallja e Gëzimit të së Vërtetës. Marrëveshje Globale mbi Edukimin)*, Media House, Delhi 2020, fq. 194

Ky libër thërret vëmendjen mbi veprimtarinë e Jezusit dhe parimin e Mishërimit, duke iu referuar nismave të papës Françesku mbi edukimin: Marrëveshja edukative globale dhe dokumenti Veritatis Gaudium, Gëzimi i Ungjillit. Kjo vepër dëshiron të ngjallë gëzimin e së Vërtetës nëpërmjet figurave të Marisë së Nazaretit, Françeskut të Asizit dhe papës Françesku.

Vëllimi përbëhet nga pesë kapituj. I pari dëshiron të vërë në dukje modalitetin me të cilin Françesku i Asizit ka ndezur gëzimin e shërbimit dhe të së vërtetës në Evropën e Mesjetës. Në zemrën e kapitullit të dytë gjejmë “humanizmin e ri” të Françeskut, aftësinë e tij në nivel edukativ, të bashkëndarë me shën Antonin e Padovës. Në kapitullin e tretë merret në shqyrtim aspekti edukativ në jetën e Virgjërës Mari, i vënë përballë “Marrëveshjes së Krishterë për Edukimin” në jetën e Françeskut të Asizit dhe pas tij – në shkrimet e zgjedhura të Duns Skotit, të Koncilit II të Vatikanit dhe të papës Françesku. Në kapitullin e katërt trajtohet aspekti edukativ në magjsterin e papës Françesku nëpërmjet dokumenteve të tij Laudato Si', Admirabile Signum dhe Veritatis Gaudium. Kapitulli i fundit i është kushtuar nevojës për të hyrë në Gëzimin e së Vërtetës si hap themelor përpara drejt një ungjillëzimi “të mbushur prej Shpirtit”, një “solidariteti universal”, një “humanizmi të ri” dhe një “njerëzimi të ri”.



GWENOLÉ JAUSSET OFM, *Envoyé vers les frères de l'autre rive (I dërguar drejt vëllezërve të bregut tjetër)*, Chemins de Dialogue, Marseille 2019, fq. 167

Me rastin e 800-vjetorit të takimit të Françeskut të Asizit me sulltanin al-Malik-al-Kamil në Damieta në vitin 1219, Gwenolé Jausset e ka rilexuar itinerarin e tij si frat minor i dërguar prej Urdhrit françeskan te vëllezërit “e bregut tjetër”: një itinerar në të cilin ka vënë në jetë këshillat që Françesku u ka drejtuar fretërve që takojnë myslimanët. Prej vendlindjes së tij Bretanja deri në Stamboll, duke kaluar nëpër Bregun e Fildishtë dhe vendet e shumta të vizituara, e drejton një fill i kuq shpirtëror: ai i takimit dhe i miqësisë së zhvilluar me myslimanët, në të cilën ka tërhequr familjen françeskane. Për të endur dialogun, ai bashkë me vëllazërinë, takimin, dialogun dhe lutjen.

NGJARJE



Terra Sancta Organ Festival, festivali më i madh i muzikës organistike të Lindjes së Mesme dhe të Lindjes, ka përruar sezonin e vet të ri muzikor më 5 tetor 2020. Në pritje që publiku të mund të pranohet përsëri, koncertet bëhen pa spektatorë dhe transmetohen nëpërmjet internetit. Për këtë arsye, sezonin tradicional të koncerteve – në vendet ku do të mund të bëhen me publik – i shtohet edhe “Internet Pipe Organ Season”, i menduar shprehimisht për t’u shikuar në kompjuter, smartphone dhe tablet, me koncerte në live streaming, produksione të reja të propozuara si premiera dhe koncerte të plota që nuk janë paraqitur në edicionet e kaluara. Për të konsultuar programin e plotë apo për të parë koncertet e ardhshme:

www.tsorganfestival.org

AXHENDA MINISTRI GJENERAL

NËNTOR 2020

2-8

ROMË

Kohë e fortë

9

ROMË

Festa e

Të lumit Gjon Duns Skot

10-30

ROMË

Studim dhe punë

për përgatitjen


për Kapitullin gjeneral

25-27

ROMË

Asambleja USG

(Eprorët Gjeneralë)



VOTA NË WILD WEST (SHBA)

Këto ditë kur flitet shumë për zgjedhjet e ardhshme presidenciale, kjo foto në të majtë ka kapur një moment shumë ndryshe.

Anselm Weber OFM e shpreh votën e vet gjatë zgjedhjeve në territorin e atëhershëm të Arizonës në vitin 1906. Arizona u bë një shtet i Shteteve të Bashkuara vetëm në vitin 1912.

Anselmi që një ndër themeluesit e Misionit të Shën Mikelit në 1898, misioni i parë katolik i përhershëm pranë popullit Navajo. Së bashku me një frater tjetër, Berard Haile, publikoi vepra të shumta mbi gjuhën navajo, mes të cilave edhe fjalorë dhe gramatika.